



PROCESVERBAL X /2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së X (dhjetë) për vitin 2022 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.10.2022
Ora : 11:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për lirimin nga pagesa e shërbimeve mjekësore “Mamografisë” ;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të ndërhyrjes ndër-sektoriale për ndryshime klimatike për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2028;**
- 5. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Shator 2022;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit. Arta Tex është duke e zhvillu veprimtarinë atje dhe mendoj që duhet me shku në Asamble. Nëse kemi diçka rreth dokumentit të vendimit e themi në Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për lirimin nga pagesa e shërbimeve mjekësore “Mamografisë” ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Paraprakisht mendoj që është vendim i vonuar, veq asaj që duhet me përkrah për me shku në Asamble. A kanë qenë të liruar ndonjëherë?

Habibe Bytyqi - vetëm gjatë muajit tetor.

Dardan Berisha - paraprakisht është mirë me pas një raport, se sa është numri i grave që i bëjnë inqizimet. Me çfarë kodi buxhetor ka me u mbulu kjo?

Avni Bytyqi - kjo vetëm krijon të hyra dhe është 5 euro shërbimi.

Urim Suka - e përshëndes iniciativën e grave asamblistë. E mbështes si vendim, por unë dua të ngris disa shqetësime sepse ne shpeshherë kemi marrë vendime të paanalizuara mirë dhe pastaj kemi dalë në situata

ku edhe jemi detyrua me i ndërpre ato vendime. A ka kapacitet QKMF-ja për me i përballu dhe me arrite me i krye këto shërbime?

Fidaije Kukaj - përshëndet të pranishmit. Mamografi ka dal në një pjesë tjetër të Ambulantes dhe do të punojë çdo ditë, dhe mendoj që ka me pas kapacitet.

Kryesuesi - sa e di,muajin që jemi është pa pagesë.

Fidaije Kukaj - pjesa e pacientëve që janë me diagnozë,lirohen nga pagesa.

Urim Suka - shqetësimi që unë ngrita ka të bëjë me funksionimin,dhe jo me ndodhë një situatë ku marrim vendime që nuk funksionojnë.

Kryesuesi - desha të ngris një shqetësim. Mamografi a lexohet këtu apo jo?

Fidaije Kukaj - doktoresha është në trajnim për leximin e mamografisë dhe besoj që prej nëntorit do të fillojë të punojë në QKMF.Pra, mamografia do të bëhet çdo ditë dhe do të lexohet te ne.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ndërlihem te pjesa e funksionalizimit,sepse edhe ne kemi pas dilemat tona si gr.i garve,dhe ka qenë shqetësuese se pse mamografi po punon vetëm dy ditë në javë dhe po kryhen dy paciente brenda ditës. Për këtë arsye kemi organizuar me mbajte një takim me drejtoreshën QKMF-së,ku në takim na tha që janë bo disa renovime dhe mamografia tash e tutje ka me pune çdo ditë pune. Qëllimi jonë ka qenë që mamografi me qenë pa pagesë për shkak se edhe pse është me pagesë minimale, po ndikon në opinion sidomos te ato që nuk kanë informacion të saktë se sa kushton.Besoj që qëllimi jonë po shkon drejt realizimit, nëse mbështetet kjo pikë edhe nga anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi - e përgëzoj grupin e grave që janë aktive.

Urim Suka - sa ma shumë që angazhohen gratë,është jashtëzakonisht e mirë,dhe unë i inkurajoj grupin e grave të marrin sa ma shumë aktivitete, dhe mbështetja ime është njëqind për qind.

Kryesuesi - meqenëse je udhëheqëse e grupit të grave, kam kërkesë që me pas një raport se sa janë kërkesat.

Urim Suka - shqetësimi im që e ngrita është që kur t' del informata që ky shërbim është falas,fluksi mund të rritet dhe a ka kapacitet QKMF-ja me përballu. Shqetësimi i dytë është se ai inqizim,a është shumë profesional dhe funksional. Për këto dy pika është mirë si institucione me analizu dhe me shty përpara si ide.

Sanie Kuçi Rexhepaj - do të kontaktoj me drejtoreshën, dhe i kërkoj që me qenë pjesë e takimit të Asamblesë dhe do ti tregoj edhe për çështjet që janë ngritë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të ndërhyrjes ndër-sektoriale për ndryshime klimatike për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2028;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që për çdo sqarim prezent në takim është anëtar i cili ka punuar në këtë plan së bashku me Drejtorin e Shërbimeve Publike.

Enver Shabani - Në fillim të vitit 2022 Kryetari i Komunës ka lidhë një marrëveshje bashkëpunimi me UNDP-në. Marrëveshja është tre vjeçare dhe kjo marrëveshje e obligon Komunën që gjatë tre viteve të ardhshëm me pas raporte të bashkëpunimit për interesat e ndryshimit klimatik. Në kuadër të marrëveshjes UNDP ka organizu dhe ftu konsulentë të vet nga fusha të ndryshme dhe përfaqësues i të gjithë konsulentëve dhe ekspert i fushës ka qenë Maliq Pereci. Kurse ne si Komunë kemi pas obligim me formu grupin punues i cili është i formuar prej 32 anëtarëve. Deri më tani janë mbajte 4 takime të përbashkëta me UNDP-në për konsultime dhe shkëmbim të informatave dhe nevojat të cilat janë për Komunën e Suharekë,dhe kemi arrit në këtë pikë ku u bë një plan draft që pothuaj është final dhe kërkon miratimin e Asamblesë.

Urim Suka - kur është formuar grupi punues?

Enver Shabani - grupi punues u formu rreth një muaj pas marrëveshjes me UNDP-në,besoj në prill.

Maliq Pereci - përshëndet të pranishmit. Falënderoj Komunën për bashkëpunimin dhe mënyra se si është kriju grupi punues është e mirë,për shkak se i juaji është diverzifikues brenda. Janë të gjithë sektorët e integruar,që është edhe ideja e planit. Ideja e këtij plani është që kjo të ketë ndërlidhje në mes të sektorëve dhe të zhvillohen projekte të cilat kanë me ndihmuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike përmes rritjes së

efiqensës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë. Për shkak se ndryshimet klimatike po ndodhin, një pjesë e ndryshimeve është e pakthyeshme, andaj duhet që komuna të përgatit ide dhe projekte për me u përshtat ndaj këtyre ndryshimeve. Maliq Pereci tutje elaboron projektin rreth planit të ndërhyrjes ndërsektoriale për ndryshime klimatike për Komunën e Suharekës.

Kryesuesi - a ka fillu të implementimet kjo edhe në Komunitet tjera apo është hera e parë në Komunën tonë?

Maliq Pereci - në nivel të Kosovës, Kosova e ka strategjinë për ndryshimet klimatike, e cila është bërë në vitin 2014 dhe ripërtërihet vazhdimisht, ndërsa në nivel të Komunave, Komunitet deri tani nuk kanë pas këso plane, por Komunitet kanë pas plane që lidhen me ndryshime klimatike të pjesa e pengimit. Në nivel vendi është duke u përgatit plani për energji dhe klimë.

Urim Suka - marrëveshja Komunitet-UNDP është bërë vetëm për me marrë këtë plan dhe përfundon këtu, apo kjo marrëveshje mund të ndodhë me thirrje tjera për me implementu të tjera?

Enver Shabani - marrëveshja që lidhet me UNDP-së dhe Komunës është se UNDP ka 1 milion euro dhe nëse ne arrijmë me marrë projekte, kemi të drejtë me marrë deri në 1 milion, por është e përbashkët edhe për Prizrenin. Tri projekte veç kanë filluar me procedurë por jo me u implementu. P.sh. do të bëhet efqenca për ambulancën në Suharekë, për bibliotekën me solarë dhe ambulancën në Bukosh.

Urim Suka - shqetësimet që kam dhe që i them vazhdimisht, është se Komuna po harton disa plane-dokumente, ku zakonisht po marrim materiale copy-paste, dhe po i sjellim këtu, po i miratojnë dhe kur po fillon implementimi, gati asgjë s'po bëjmë për ato. Këtë e them sepse e lidhi me strategjinë që e kemi miratuar më herët dhe gati asgjë s'është duke u bërë. Uroj që këto dokumente që bëhen, Kryetari dhe ekzekutivi të shkojnë se çka prej tyre mund të bëhen, që me fillua me i implementu diçka, që sado pak me ndiku në ndikimin e ngrohjes globale.

Maliq Pereci - keni të drejtë në shqetësimin që e thatë. Ka mjaft raste që planifikimi nuk është bërë në kontekstin e vendit dhe atë ma shumë në kontekstin lokal, sepse komuna prej komunës dallon. Analiza është bërë në bazë të analizës së rrezeve ndaj ndryshimeve klimatike. Një pjesë janë marrë prej ideve të cilat kanë ardhë prej grupit punues, një pjesë janë marrë prej dokumenteve zhvillimore, sidomos prej Hartës Zonale. Në plan shkruan se a është propozim i ri apo është propozim ekzistues, për shkak se këto janë mbledh dhe janë shkruar në kontekstin e ndryshimeve klimatike. Metodologjia ka copy-paste, sepse metodologjia se si është krijuar, kjo nuk është e zbuluar dhe është marrë prej përvojave të vendeve tjera, ndërsa në aspektin e projekteve është një plan shumë origjinal dhe i zbatueshëm. Maliq Pereci tutje jep sqarime edhe rreth zbatimit të këtij plani.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Shator 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - të realizimi i buxhetit, të investimet kapitale po figuron që buxheti është realizu 38.26 %. Realisht është shqetësim për mua sepse për 9 muaj keni arrit me shpenzuar 38 %, ndërsa për dy muaj keni me shpenzuar edhe 62 % të tjera. Kjo ka me ju krijuar vështirësi dhe Komuna ka me dal me një situatë ku ju ndoshta duhet me i krye ato punë shpejt edhe jashtë procedurave. Unë do përpqem ti përcjell këto shpenzime që ju bëni dhe uroj të mos bëni shkelje ligjore, sepse ne do ti adresojmë.

Kam disa shqetësime dhe kërkoj sqarime. P.sh. Administrata: Avans për udhëtime zyrtare-6 mijë euro. Mirëmbajtja e ndërtesave-administrata afariste -37.000 euro. Administrata: Qiraja, përdorimi i hapësirave-3.200 euro. Zyra e Kuvendit: Shërbime të ndryshme intelektuale këshilluese-3.200 euro. Shërbimet Publike: Furnizim me rrymë, gjenerator-66 mijë euro. Drejtoria e Financave: Shpenzime postare-6.700 euro. Shpenzime për anëtarësim 2.900 euro. Avans për udhëtime zyrtare-3.000 euro. Qiraj në bujqësi 818 euro. Urbanizmi: Udhëtime zyrtare-3.109 euro. Drejtoria e Pronës: Shërbime këshilluese-2.000 euro. Kultura: udhëtime zyrtare-3.600 euro. Administrata e shëndetësisë: 4.400 euro qiraja e ndërtesës.

Kryesuesi, Drejtori i Financave, Drejtori i Sh. Publike dhe zyrtari ligjor japin përgjigje rreth pyetjeve.

Enver Shabani - shpenzimi i buxhetit ka fillu në muajin e 6-shtë dhe kjo i bie që për 3 muaj janë shpenzuar 38.26 %. D.SH. Publike prej investimeve kapitale deri sot ka shpenzuar 46 % nga të hyrat buxhetore. Ndërsa të hyrat vetanake edhe nëse nuk i shpenzojmë 100 %,ato nuk humbin por janë mjete që barten.

Urim Suka - buxheti është lëshuar në maj dhe keni muajt me i bo gati procedurat dhe mos me i vonuar. Nëse ju keni me i shkel këto procedura, ne kemi me i adresuar një nga një.

Dardan Berisha - dua të ndalem te Drejtoria e Arsimit që është problem në nivel t'Kosovës, te pagesat që nuk iu bëhen mësimdhënësve për shujta. Mësimdhënësit e Komunës së Suharekës lëndën e kanë dërguar në përmbaues dhe janë 894.56 euro që Komuna paguan. Duhet të zgjidhet ky problem, ose përmes asociacionit të Komunave me shkëput marrëveshjen. Sa e di në Komunën e Skenderajit është arrit një lloj marrëveshje me mësimdhënës, më i paguar si lloj rate në mënyrë që mos me shkuar në përmbaues. Drejtori ose kush do çoftë përgjegjës,me gjet një zgjidhje në këtë drejtim.

Kryesuesi - sa e di kontrata kolektive ka një afat.

Dardan Berisha - nuk ka afat. Është memorandum marrëveshje dhe këtë marrëveshje mundet me shkëput vetëm asociacioni i Komunave.

Avni Bytyqi - asnjë Kryetar i Komunave nuk është interesuar me ndërpre kontratën kolektive. Kryetari duhet të planifikojë buxhet. 2017-2018 kanë qenë 120.000 euro të planifikuara për këtë çështje dhe s'kemi pas problem.

Urim Suka - ju si qeverisje është mirë me pa që 1 milion euro po shkojnë për këtë çështje. Folni me qeverinë, me ministrinë, se çfarë kemi të drejtë me bo si Komunë që me muajt me kthye këtë çështje në ligj.

Avni Bytyqi - thotë që kontrata kolektive ka afat tre vjeçare dhe neni 90 i ligjit të punës thotë që kontrata kolektive nëse nuk përtërihet në afat me periudhën tre vjeçare, konsiderohet e pa vlefshme. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - ia jep fjalën zyrtarit ligjor rreth informatës për Hartën Zonale.

Avni Bytyqi - mbledhjen e kaluar kemi miratuar Hartën Zonale dhe në projekt-vendim bashkë me kompaninë dhe ekspertët e planifikimit hapësinor, dy planet rregulluese, Zonës Industriale dhe Agro Zonën Industriale i kemi lënë në fuqi. Ministria e Planifikimit Hapësinor e kanë kthye në rishqyrtim që këto dy plane rregulluese me i shfuqizuar, e që Komunës i shkakton telashe. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime shtesë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - realisht unë kisha insistuar që ne mos me marrë veprim të ngutshëm dhe me i shfuqizuar këto plane. E di që interesi i Komunës është që Harta Zonale me hy në fuqi sa ma shpejtë,por në anën tjetër është interes edhe këto dy plane me mbet në fuqi, për shkak që në momentin që shfuqizohen ka shumë procedurë me i ri-iniciuar hartimin e planeve të reja.

Avni Bytyqi - kam qenë anëtar i grupit punues për këto dy zona dhe tri mandate është dasht për me i licencu këto dy zona pas një pune shumë të madhe. Para se me ardh në KPF dhe Asamble miratimi i HZK-së,unë kam pas disa komunikime me MAPL-në dhe ata kanë thënë që diskutohet me Urbanizmin dhe Kompaninë që e ka hartuar draft hartën. A duhet apo jo? Mirëpo sipas gjitha gjasave Ministria nuk e kanë pasë kuptimin mes vete dhe departamenti ligjor e ka kthyer që nuk është në harmoni me nenin kaq pasi mbizotëron Harta Zonale.

Urim Suka - kërkoj që takimet e mbledhjeve të ardhshme mos të mbahen në zyrën e Kryetarit.

Kryesuesi - në sallën e bordit janë auditorët,për këtë arsye takimi u mbajt këtu.